



VENDIM

Nr. 60 Datë 10.05.2012

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LIÇENSIMIT TË SHOQËRISË HEC
“BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2” SH.A NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “a”; 9, nenit 13 pika 1 gërma “ç” dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma “f”, nenit 8 pika 4 dhe nenit 10, pikat 1 dhe 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.05.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht. (mungon **neni 9, pika 3, gërma “a”** (vërtetim për shlyerjen e tatim taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore); **neni 9, pika 3, gërma “b”**; (Paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit / ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit); **neni 9, pika 3, gërma “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe / ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qarte

vlerat monetare për financimi dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, te tjera, etj.)

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI